

Vlerësimi i

SKEMAVE MBËSHTETËSE TË BUJQËSISË

Në Kosovë



Mohimi i përgjegjesisë:

Hartimi dhe botimi i këtij dokumenti është mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) përmes projektit të vet - Promovimi i Punësimit të Sektorit Privat (PPSE), i zbatuar nga Swisscontact në konsorcium me Institutin Riinvest.

Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e PPSE-së dhe nuk paraqet domosdoshmërisht pikëpamjet e SDC-së.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC





Përmbajtja

06	Përmbledhja ekzekutive
12	Hyrje
16	Metodologjia
18	Gjetjet kryesore
19	Pjesa 1: Pasqyra e orientimit strategjik
19	Situata aktuale
24	Mungesa e strategjisë apo diçkaje tjetër?
28	Përfshirja e palëve të interesit dhe shoqatave në politikë-bërje
29	Pjesa 2: Programi i subvencioneve
32	Dizajnimi i programit të subvencioneve
38	Pjesa 3: Masat e zhvillimit rural
42	Shërbimet këshilluese, trajnimet dhe konsultimet
45	Pjesa 4: Sistemi i informacionit dhe monitorimit
49	Përfundimet dhe rekomandimet
52	Referencat

Përmbledhja ekzekutive

1

Përmbledhja ekzekutive

Projekti ‘Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSE)’ në Kosovë financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga Swisscontact-i dhe Instituti Riinvest. PPSE ka realizuar këtë studim me qëllim të vlerësimit të skemave mbështetëse të bujqësisë në Kosovë, me fokus të veçantë në nën-sektorët e frutave, perimeve dhe bimëve mjekuese aromatike. Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi ishte identifikimi i problemeve aktuale në skemat e mbështetjes dhe dizajnimi i intervenimeve potenciale që mund të përmirësojnë ndikimin e këtyre skemave mbështetëse.

Hipoteza fillestare për këtë studim është bazuar në faktin se përderisa ka pasur një rritje të qëndrueshme të këtyre nën-sektorëve të bujqësisë, rritja e sipërfaqes së përgjithshme të tokës së shfrytëzuar bujqësore përgjatë viteve ka qenë jo domethënëse. Kjo hipotezë gjithashtu është bazuar në faktin se prodhimi bujqësor ke mbetur

i njëjtë, diku tek 640 milionë euro/vit, duke bërë kështu që kontributi i bujqësisë në Produktin e Brendshëm Bruto (PBB) të ulej nga viti në vit. Hipoteza ishte që ndihmat bujqësore nuk jepnin rezultat domethënës në rritjen e prodhimit bujqësor përkundër sasisë së madhe të ndihmave të brendshme, përmes garantëve dhe programeve të subvencionimit nga qeveria qendrore dhe lokale, si dhe ndihmave të jashtme për këtë sektor.

Studimi mbi vlerësimin e skemave mbështetëse në Kosovë, i dizajnuar nga PPSE kishte këto synime:

1 Të studiojë skemat aktuale të mbështetjes bujqësore në Kosovë, duke përfshirë subvencionet e direkte dhe të tërthorta për nën-sektorët si ai i frutave, perimeve dhe bimëve mjekuese aromatike. Një qasje më e fokusuar mund të ndërmerret bazuar në rezultatet e diskutimeve/dialogut me Shoqatat e Sektorit dhe Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR);

2 Të vlerësojë efektivitetin e programit aktual të subvencioneve;

3 Të vlerësojë kadastrimin/analizimin e palëve të interesit;

4 Të identifikoj ndërhyrjet potenciale ose adaptimin e skemave të subvencioneve të cilat mund të përmirësojnë edhe më tej këtë sektor – duke veçuar nën sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyrorë – me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe gjenerimit të të ardhurave;

5 Të identifikoj rreziqet kryesore që ndërlidhen me ndërhyrjet dhe masat lehtësuese që mund të zbatohen;

6 Të bëj rekomandime specifike për Ministrinë e Bujqësisë për zbatimin e ndërhyrjeve bazuar në praktikat më të mira rajonale.

“Një nga gjetjet kryesore të këtij studimi është se bujqësia është një ndër sektorët e rrallë në Kosovë për të cilin ka një strategji – edhe pse si strategji është mjaft e gjerë me objektiva të përgjithshme rreth rritjes së sektorit të agro-ushqimit, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe mjedisit të zonave rurale”.

Për tu përgjigjur pyetjeve të këtij studimi, ky raport është ndarë në katër pjesë kryesore. Pjesa e parë flet paraqet një pasqyrë të orientimit strategjik dhe të situatës aktuale të sektorit të bujqësisë sa i përket ndikimit të skemave mbështetëse. Pjesa e dytë analizon skemat e programit të subvencioneve (pagesat direkte), dizajnimin e tyre dhe krahason ato me praktikën e ngjashme në Ballkanin Perëndimor. Pjesa e tretë ofron një përmbledhje të masave të zhvillimit rural (programet e granteve), dizajnimin dhe zbatimin e tyre në shtete të ndryshme. Pjesa e katërt, analizon sistemet e informacionit, sistemin e monitorimit dhe sfidat që ndërliken me besueshmërinë e statistikave për sektorin e bujqësisë.

Një nga gjetjet kryesore të këtij studimi është se bujqësia është një ndër sektorët e rrallë në Kosovë për të cilin ka një strategji – edhe pse si strategji është mjaft e gjerë me objektiva të përgjithshme rreth rritjes së sektorit të agro-ushqimit, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe mjedisit të zonave rurale, dhe përmirësimit të cilësisë së jetës dhe diversifikimit të mundësive dhe punësimit në zona rurale. Sidoqoftë, sektori i bujqësisë nuk ka një strategji të përqendruar në këta nën-sektorë, të bazuar në analizat e tregut për zëvendësim të importit apo rritje të eksportit. Për më tepër, edhe pse zhvillimi dhe dizajnimi i çdo programi vjetor është i bazuar në analizat sektoriale, dhe analizimin e zinxhirit të vlerës për çdo kulturë bujqësore, mbështetja me grante dhe subvencione nuk është i koordinuar si duhet në funksion të plotësimit ose përmirësimit të të gjitha pjesëve të zinxhirit të vlerës.

Bazuar në atë që u tha më lartë, rekomandohet që të bëhet identifikimi i kulturave të cilat janë me interes kombëtar për Kosovën, në mënyrë që të zëvendësohen importet me prodhimet vendore, dhe të fokusohet në kultivimin e kulturave të cilat mund të jenë konkurruese në tregun ndërkombëtar. Veç tjerash, zinxhiri i vlerës duhet të analizohet në tërësi për të vlerësuar nëse të gjitha programet mbështetëse shpijnë drejt qëllimit për kompletimin e zinxhirit të vlerës.

Një përfundim tjetër i rëndësishëm i këtij studimi është se politikat e hartuara nga MBPZHR nuk merren seriozisht gjatë shpërndarjes të buxhetit të Kosovës. Si pasojë, të gjitha palët e interesit duhet

të rrisin aktivitetet e tyre avokuese drejt qeverisë dhe kuvendit për të bërë ndryshimet e nevojshme buxhetore, të cilat shërbejnë për arritjen e qëllimeve dhe planeve të ministrisë.

Sa i përket programit të subvencioneve, vërehet se rezultate janë të pakënaqshme dhe të paqëndrueshme nga sektori në sektor. Programi i subvencioneve nuk ndikon në rritjen e prodhimit dhe rendimentit të kulturave bujqësore, përkundrazi i njëjti vetëm subvencionon një pjesë më të madhe të shpenzimeve për të prodhuar sasi të njëjta. Prandaj, programi i subvencioneve duhet të ri-dizajnohet në dy nivele, ku niveli i parë mbështet të gjithë tokën bujqësore që kultivohet me një pagesë minimale, ndërsa niveli i dytë mbështet vetëm produktet strategjike, qoftë në bazë të lëndës së parë apo në bazë të nivelit të prodhimit.

Në masat e zhvillimit rural ka një kontroll të dobët të zbatimit të granteve dhe mungesë të matjeve të duhura të efekteve dhe rezultateve të arritura nga projektet e ndryshme. Agjencia për Zhvillimin e Bujqësisë (AZHB), përkundër burimeve të kufizuara njerëzore dhe atyre buxhetore ka procedura dhe doracakë, të cilat gjejnë zbatim të vogël gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit. Prandaj, programet e granteve duhet të monitorohen dhe të gjurmohen më rreptë, në mënyrë që të arrihet rezultati i synuar nga mbështetjen e ofruara. Për më tepër, qeveria dhe kuvendi duhet të mbështesin AZHB-në me buxhet dhe staf.

Projektet për zhvillim gjithashtu kanë mungesë të këshillimit profesional për kultivimin e kulturave bujqësore, zhvillimit dhe përpunimit të aftësive pas-prodhimit, modeleve të biznesit, qeverisjes korporative dhe strategjive të shitjes. Në këtë drejtim, përfshirja e shërbimeve këshilluese, përmes këshilluesve profesionistë në projektet e granteve, duhet të jetë kërkesë e detyrueshme. Të gjitha palët e interesit në sektorin e bujqësisë duhet të investojnë në zhvillimin e kapaciteteve të shërbimeve këshilluese, pasi përfshirja e lartë e shërbimeve të tilla në projekte do të kontribuojë drejt stabilitetit dhe suksesit më të madh të masave mbështetëse, gjë që do të rezultojë në një sektor të qëndrueshëm bujqësor në tërësi.

Sa i përket sistemit të informacionit dhe monitorimit, evidentohet mungesë e të dhënave dhe statistikave të qëndrueshme për sektorin e bujqësisë në Kosovë. Duke marrë këtë parasysh, duhet të përcaktohet një metodologji dhe procedurë standarde për procesin e grumbullimit, përpunimit, vërtetimit dhe analizimit të të dhënave në databazat e MBPZHR-së. Kjo metodologji, gjithashtu duhet të përfshijë të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) si dhe të dhëna nga niveli komunal (komunat), në mënyrë që të dokumentojë dhe menaxhojë të gjitha të dhënat, duke ofruar një tablo të qartë të sektorit të bujqësisë.

Hyrje

Promovimi i Punësimit në Sektorin Privat (PPSP) është një projekt në Kosovë i financuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) dhe zbatohet nga një konsorcium ndërmjet Swisscontact-it dhe Institutit Riinvest. Faza e parë e projektit është zhvilluar nga viti 2013 deri në vitin 2017. Duke filluar nga nëntori i vitit 2017 projekti u zgjat deri në vitin 2021 dhe qëllimet e projektit mbetën të ngjashme si në fazën e parë, duke arritur kështu ndikim të qëndrueshëm në shkallë të gjerë në punësimin e grave dhe burrave përmes përmirësimit të konkurrueshmërisë së sektorit privat. Projekti përdor qasjen e Zhvillimit të Sistemit të Tregut (ang. Market Systems Development) (MSD), e njohur më parë si qasja e bërjes së tregjeve që të funksionojnë për të varfrit (ang. Making Markets Work for the Poor) (M4P), duke përdorur analizën praktike të sektorit që përfshin problemet e sektorit, shkaktarët themelorë, shërbimet e ndërlidhura dhe dobësitë e tyre, aktorët dhe

ndërhyrjet e propozuara.

Ngjashëm me fazën e parë, projekti është përqendruar në dy sektorë, përkatësisht turizmin dhe ushqimin dhe përbërësit natyralë (përfshirë nën-sektorët siç janë frutat dhe perimet, produktet pyjore jo drusore, konditorinë, etj.). Me një fokus të veçantë në sektorët e caktuar, qëllimet e projektit janë rritja e mundësive të punësimit, krijimi i të ardhurave, si dhe konkurrueshmëria në sektor dhe performanca e aktorëve në zinxhirin e vlerës.

Si pjesë e përkrahjes në sektorët e lartpërmendur, PPSE-ja kishte për synim të hartonte një studim për të vlerësuar skemat e ndihmës bujqësore në Kosovë, me një fokus të veçantë në nën-sektorët e frutave, perimeve dhe bimëve mjekuese aromatike. Qëllimi i përgjithshëm i këtij studimi ishte identifikimi i çështjeve aktuale në skemat e mbështetjes dhe hartimi i ndërhyrjeve të mundshme që mund të përmirësojnë ndikimin e këtyre skemave

mbështetëse.

Hipoteza fillestare për këtë studim u bazua në disa fakte të identifikuara nga studimet e kaluara dhe statistikatat aktuale. Toka e përgjithshme e përdorur për bujqësi në Kosovë është 416,831 hektarë (ha), megjithatë më shumë se gjysma e saj janë livadhe dhe kullosa (53%) dhe gjysma tjetër është tokë e punueshme që përdoret për produkte të ndryshme bujqësore (43%). Megjithëse ka pasur një rritje të vazhdueshme të nën-sektorëve të përzgjedhur të bujqësisë, rritja e sipërfaqes totale të tokës bujqësore të shfrytëzuar në Kosovë ishte jo domethënëse gjatë viteve të kaluara.

Përveç kësaj, megjithëse PBB-ja e Kosovës është rritur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite, nga 4.8 miliardë euro në vitin 2011 në 6 miliardë euro në vitin 2016, prodhimi bujqësor për fat të keq ka mbetur i njëjtë, në rreth 630 milionë Euro, duke bërë që kontributi i bujqësisë në PBB të bjerë ndër vite.

Duke marrë parasysh sasinë e madhe të ndihmës së brendshme në sektorin e bujqësisë në Kosovë përmes granteve dhe programeve të subvencioneve të qeverisë qendrore dhe lokale, si dhe ndihmën e jashtme për këtë sektor, supozimi ishte se duhet të ketë një rishikim serioz të zhvillimit të sektorit të bujqësisë, pasi të dhënat tregojnë se nuk ka pasur ndonjë rezultat domethënës nga kjo ndihmë në rritjen e prodhimit bujqësor në Kosovë në tërësi. Për më tepër, hipoteza ishte se një pjesë e rëndësishme e këtij rishikimi duhet të përqendrohet në skemat e mbështetjes.

Prandaj, studimi mbi vlerësimin e skemave të mbështetjes në Kosovë i hartuar nga PPSE kishte këto synime:



Përveç kësaj, megjithëse PBB-ja e Kosovës është rritur në mënyrë të vazhdueshme ndër vite, nga 4.8 miliardë euro në vitin 2011 në 6 miliardë euro në vitin 2016, prodhimi bujqësor për fat të keq ka mbetur i njëjtë, në rreth 630 milionë Euro, duke bërë që kontributi i bujqësisë në PBB të bjerë ndër vite.

1 Të studiojë skemat aktuale të mbështetjes bujqësore në Kosovë, duke përfshirë subvencionet direkte dhe të tërthorta për nën-sektorët si ai i frutave, perimeve dhe bimëve mjekuese aromatike. Një qasje më e fokusuar mund të ndërmerret bazuar në rezultatet e diskutimeve/dialogut me Shoqatat e Sektorit dhe MBPZHR-në;

2 Të vlerësojë efektivitetin e programit aktual të subvencioneve;

3 Të vlerësojë kadastrimin/analizimin e palëve të interesit;

4 Të identifikoj ndërhyrjet potenciale ose adaptimin e skemave të subvencioneve të cilat mund të përmirësojnë edhe më tej këtë sektor – duke veçuar nën sektorët e ushqimit dhe përbërësve natyrorë – me qëllim të krijimit të vendeve të punës dhe gjenerimit të të ardhurave;

5 Të identifikoj rreziqet kryesore që ndërlidhen me ndërhyrjet dhe masat lehtësuese që mund të zbatohen;

6 Të bëj rekomandime specifike për Ministrinë e Bujqësisë për zbatimin e ndërhyrjeve bazuar në praktikat më të mira rajonale.

Metodologjia

Metodologjia për këtë projekt është hartuar nga një konsulent dhe më pas është adoptuar dhe përfunduar në bashkëpunim me PPSE-në dhe Institutin Riinvest.

Për të përmbushur qëllimin dhe objektivat specifike të këtij projekti, janë përdorur dy qasje kryesore për mbledhjen e të dhënave: hulumtimi nga burime sekondare dhe hulumtimi cilësor. Nga njëra anë, hulumtimi nga burime sekondare ishte përqendruar në mbledhjen dhe analizën e të dhënave sekondare për sektorin e bujqësisë në Kosovë dhe Ballkanin Perëndimor nga burime të ndryshme. Nga ana tjetër, për hulumtimin cilësor janë përdorur dy teknika kërkimore: intervista të thella dhe punëtori me palët përkatëse të interesit në Kosovë.

Burimet e përdorura për mbledhjen dhe analizën e të dhënave sekondare përfshijnë MBPZHR-në e Republikës së Kosovës; AZHB-në e Republikës së Kosovës; ASK-në; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Republikës së Shqipërisë; Ministrinë e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit të Republikës së Serbisë; Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural të Malit të Zi; Ministrinë

e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ekonomisë së Ujërave të Maqedonisë së Veriut; Ministrinë e Bujqësisë, Menaxhimit të Ujërave dhe Pylltarisë së Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës; dhe JRC Science Hub (Joint Research Gate - Porta e Përbashkët e Kërkimit).

Pjesëmarrësit në hulumtimin cilësor ishin palët e interesit nga shoqatat përkatëse të sektorit, fermerët, prodhuesit dhe përpunuesit; MBPZHR-së; si dhe organizata donatorësh ndërkombëtarë. Gjithsej janë kryer 10 intervista të thella me palët përkatëse të interesit, me një gjatësi mesatare të intervistës ndërmjet 40-60 minutave. Në disa raste, janë organizuar diskutime vijuese me palët e interesit nga MBPZHR-ja për të diskutuar gjetjet dhe rekomandimet e mundshme. Punëtorja u organizua në bashkëpunim me PPSE-në dhe Institutin Riinvest, ku morën pjesë 21 persona dhe diskutimi zgjati 3 orë.

Gjetjet kryesore

4


Gjetjet kryesore

Pjesa 1: Pasqyra e orientimit strategjik

Situata aktuale

Totali i tokës së shfrytëzueshme për bujqësi në Kosovë që nga viti 2017 është 416,072 ha, ku gjysma e saj (53%) janë livadhe dhe kullosa, ndërsa pjesa tjetër është tokë e punueshme, e përdorur për produkte të ndryshme bujqësore (47%). Rritja e sipërfaqes së tokës bujqësore të shfrytëzuar në Kosovë ka qenë jo domethënës përgjatë viteve të fundit. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore të shfrytëzuar mbeti pothuajse e njëjtë nga viti 2016 deri në vitin 2017, pa ndonjë


ndryshim të madh në mes të tokave të përdorura për kultivimin e kulturave të ndryshme. Për dallim nga viti i kaluar, viti 2016 shënoi një rritje të tokës bujqësore të shfrytëzueshme, veçanërisht për fruta dhe perime. Sidoqoftë, duke marrë parasysh që totali i tokës bujqësore të shfrytëzueshme për fruta dhe perime është shumë e vogël (4%), mund të konkludohet që këto rritje nuk ka pasur ndonjë ndikim në totalin e prodhimit bujqësor në Kosovë.



	2015	2016	2017	Diferenca	Diferenca në %	Pjesëmarrja në %
Toka e punueshme (pa perime)	178129	178902	178454	-448	-0.25	42.9
Perimet	7257	8321	8500	179	2.15	2.0
- nga e cila perimet në fushë të hapur (të korrat e para)	6859	7864	8033	169	2.15	1.9
- nga e cila perimet në sera (të korrat e para)	398	457	467	10	2.19	-
Kopshtet	587	994	1199	205	20.62	0.3
Pemë frutore	4727	5493	6247	754	13.73	1.5
Vreshtat	3068	3117	3199	87	2.80	0.8
Fidanët	178	196	159	-37	-18.88	0.0
Livadhet dhe kullosat (përfshirë tokën e përbashkët)	216481	218808	218314	-494	-0.23	52.5
Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore të shfrytëzuar	410427	415831	416072	246	0.06	100

Tabela 1: Zona e shfrytëzuar e tokës bujqësore
Burimi: Rezultatet e ASK-së nga sondazhi i pronave bujqësore, 2017

Kontributi i sektorit të bujqësisë në PBB në milionë €, 2011-2017



Grafiku 1: Kontributi i sektorit të bujqësisë në PBB
Burimi: Katalogu ekonomik për prodhime bujqësore, 2018

PBB-ja e Kosovës është rritur vazhdimisht gjatë viteve të fundit, nga 4.8 miliardë euro në vitin 2011 në 6.4 miliardë euro në vitin 2017. Kur shikohen shifrat totale të prodhimit bujqësor në Kosovë, mund të konkludohet se prodhimi bujqësor ka mbetur i njëjtë, me një mesatare rreth 620 milionë euro përgjatë 7 viteve të fundit. Për më tepër, prodhimi bujqësor në vitin 2017 ka shënuar prodhimin më të ulët që nga viti 2011- atë prej 586 milionë eurove. Këto shifra tregojnë se kontributi i bujqësisë në PBB ka rënë përgjatë viteve, nga 13% sa ishte në vitin 2011, në 9% në vitin 2017.

Kur analizojmë në mënyrë më të detajuar llogaritë bujqësore, arrijmë në përfundimin se ka dallime të rëndësishme ndërmjet nën-sektorëve sa i përket tokës së shfrytëzueshme, rendimentit dhe prodhimit. Për shembull, përkundër rënies të konsiderueshme të tokës së përdorur për drithëra, nga 137,215 ha sa ka pasur në vitin 2012 në 120,746 ha në vitin 2017, prodhimi i këtyre kulturave në tonelata tregon se ka pasur një rritje të vazhdueshme të rendimentit të kësaj kulture në Kosovë. Në vitin 2012, Kosova ka prodhuar 438,792 tonelata drithëra, ndërsa në 2017 prodhimi arriti shifrën prej 477,880 tonelatave, me prodhimin maksimal të arritur një vit më parë, atë të vitit 2016 prej 562,899 tonelatave. Si rrjedhojë, edhe shifrat e rendimentit tregojnë të njëjtin trend, me rritje prej 3.2 tonelata/ha sa kishte në 2012, në 4 tonelata/ha në 2017.

		2012	2013	2014	2015	2016	2017
Drithëra	ha	137,215	141,912	131,949	134,886	134,571	120,746
	t	438,792	540,136	463,581	443,584	562,899	477,880
	Rendiment	3.20	3.81	3.51	3.29	4.18	3.96
Perime	ha	14,557	16,356	15,854	14,656	17,395	19,643
	t	163,146	235,326	221,330	246,096	335,467	358,394
	Rendiment	11.21	14.39	13.96	16.79	19.29	18.25
Fruta	ha	7,082	8,342	6,921	7,998	8,785	9,541
	t	59,633	76,702	45,873	70,096	78,502	49,571
	Rendiment	8.42	9.19	6.63	8.76	8.94	5.20
Gjedhet	kokë	329,213	321,113	261,689	258,504	264,971	259,729
	mil. €	60.0	58.6	50.5	41.4	40.9	41.4
Dele dhe dhi	kokë	247,901	216,577	212,014	224,096	212,040	210,688
	mil. €	6.2	5.6	5.4	5.6	5.2	5.2

Tabela 2: Hektar, prodhimi dhe rendimenti për sektor
Burimi: Raporti i gjelbër, 2018

Situata në sektorin e perimeve është ndryshe. Rritja e tokës së shfrytëzueshme për prodhimin e perimeve është mjaftë domethënëse - nga 14,557 ha sa kishte në vitin 2012 në 19,643 ha në vitin 2017. Për më tepër, dhe me më rëndësi, është se prodhimi dhe rendimenti i perimeve është rritur ndjeshëm me kalimin e viteve. Përveç ndikimit të rritjes së tokës së shfrytëzueshme për prodhimin e perimeve, rritja e ndjeshme e rendimentit nga 11.2 tonelata/ha sa ishte në vitin 2012 në 18.3 tonelata/ha në vitin 2017, më shumë se ka dyfishuar prodhimin e perimeve në Kosovë. Në vitin 2012, Kosova prodhonte diku rreth 163,146 tonelata perime, ndërsa vitin e kaluar (2017) arriti maksimumin e prodhimit në 358,394 tonelata.

Në anën tjetër, nën-sektori i frutave edhe pse kishte një rritje të vazhdueshme të sipërfaqes së tokës të shfrytëzueshme për prodhimin e tyre, nga 7,082 ha në vitin 2012, në 9,541 ha në vitin 2017, ka pasur probleme me rendimentin dhe prodhimin, kryesisht për shkak të ndikimit sezonal dhe atij klimatik. Të dhënat tregojnë një rënie të mbrehtë të prodhimit të perimeve përgjatë vitit 2014 dhe vitit 2017, duke e bërë nën-sektorin e paqëndrueshëm dhe të paparashikueshëm.

Perime

Fruta

Ndryshe nga drithërat, nën-sektori i frutave dhe perimeve, përkundër problemeve të identifikuara, kanë trend pozitiv - gjë e cila nuk mund të thuhet edhe për nën-sektorin e bagëtive. Kjo ngase numri i gjedheve ka rënë nga 329,213 krerë sa ka pasur në vitin 2012 në 259,729 krerë, në vitin 2017, duke zvogëluar vlerën e prodhimit me nga rreth 60 milionë euro në vitin 2012 deri në 41 milionë euro, në vitin 2017. Trende të ngjashme janë vërejtur edhe në nën-sektorin e dhive dhe deleve. Numri i krerëve në këtë nën-sektor ka rënë nga 247,901 krerë sa kishte në vitin 2012, në 210,688 në vitin 2017, dhe në vlerë, nga 6 milionë euro në vitin 2012 në 5 milionë Euro në vitin 2017.

Sidoqoftë, duke marrë parasysh sasinë e madhe të ndihmës të brendshme në sektorin e bujqësisë përmes granteve dhe programeve të subvencioneve në Kosovë, si dhe ndihmave ndërkombëtare për këtë sektor, pritshmëritë ishin se rezultatet do të ishin më pozitive. Skema e pagesave direkte përmes programit të MBPZHR-së ka trefishuar buxhetin e saj prej 8 milionë euro sa kishte në vitin 2007 në 24 milionë euro në vitin 2017. Masat e zhvillimit rajonal nga MBPZHR përmes programeve të granteve, ka rritur buxhetin e saj nga 11 milionë euro sa kishte në vitin 2014 në një buxhet prej 22 milionë eurove në vitin 2018.

“Me këto shifra, shumica e palëve të interesit në këtë sektor pajtohen se duhet të ketë një rishikim më serioz në zhvillimin e sektorit të bujqësisë pasi të dhënat tregojnë se nuk ka pasur ndonjë rezultat domethënës nga kjo ndihmë në rritjen e prodhimit bujqësor në Kosovë në tërësi”.

Për më tepër, hipoteza ishte se një pjesë e rëndësishme e saj duhet të përqendrohet në skemat ekzistuese të mbështetjes.

Mungesa e strategjisë apo diçkaje tjetër?

Një nga përfundimet kryesore të shumicës së palëve të interesit që morën pjesë në këtë studim ishte se Kosova ka mungesë të një strategjie për zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Për më tepër, krijohet përshtypja se mungesa e një strategjie të tillë po shtynë institucionet e Kosovës, dhe veçanërisht MBPZHR-në, të marrin vendime pa u përqendruar në nën-sektorët dhe kulturat e tjera, të cilat do t'i mundësonin Kosovës të ketë përparësi konkurruese si në tregun vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Sidoqoftë, Kosova ka hartuar një program të zhvillimit rural dhe bujqësor (PZhRB) për vitet 2014-2020, nga i cili burojnë programet vjetore. Përkundër faktit se PZhRB 2014-2020 është hartuar, dhe sektori funksionon duke u bazuar në të, ky program asnjëherë nuk është nënshkruar ose aprovuar nga ndonjë ministër apo qeveri e Kosovës, për shkak të arsyeve politike dhe problemeve pronësore. Megjithatë, palët e interesit nuk janë aq kritike në lidhje me këtë program. Ata besojnë se programi është relativisht i mirë dhe mund të jetë një ndër programet më të zhvilluara ndonjëherë në Kosovë. Përfaqësuesit e MBPZHR-së pretendojnë se programi është zhvilluar dhe dizajnuar duke u bazuar në analiza të hollësishme për secilin nën-sektorë përfshirë nevojat e tyre. Për më tepër, ata pretendojnë se zhvillimi dhe dizajnimet e programeve vjetore është gjithmonë i bazuar në analizat sektoriale dhe analizën e zinxhirit të vlerës për secilën kulturë.

PZhRB 2014-2020, ka analizuar nevojat e Kosovës në sektorin e bujqësisë, dhe nga analizat përmbledhëse ka përcaktuar objektivat e përgjithshme strategjike të bujqësisë dhe zhvillimit rural të Kosovës:

■ Rritja në sektorin e bujqësisë, e bazuar në konkurrencën dhe inovacionin, me rritjen e produktivitetit, e aftë për të prodhuar produkte të kualitetit të lartë në pajtueshmëri me kërkesat e tregut të Bashkimit Evropian (BE), duke kontribuar në sigurinë dhe furnizimin me ushqim, duke ndjekur qëllimet ekonomike, sociale dhe mjedisore përmes inkurajimit të punëtorëve dhe zhvillimit të kapitalit njerëzor dhe fizik.

— Mbrojtja e burimeve natyrore dhe mjedisit të zonave rurale, adresimi i sfidave të ndryshimeve klimatike përmes arritjes së përdorimit efikas dhe të qëndrueshëm të tokës dhe menaxhimit të pyjeve me futjen e metodave bujqësore për ruajtjen e mjedisit.

— Përmirësimi i cilësisë së jetës dhe diversifikimi i mundësive dhe punësimit në zonat rurale duke nxitur punësimin, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e balancuar territorial të zonave rurale.¹

Duke u bazuar në nevojat e identifikuara dhe në përputhje me objektivat e përgjithshme për bujqësi dhe zhvillim rural, janë përcaktuar edhe masat për zbatimin e programit për zhvillim rural dhe bujqësor në Kosovë, bazuar në 4 prioritetet e IPA II të BE-së për zhvillim rural. Këto masa janë prezantuar në vijim:

- 1** Përmirësimi i qëndrueshmërisë së fermës dhe shkathhtësive konkurruese
Investime në asetet fizike të ekonomive bujqësore
Investime në asetet fizike që ndërlidhen me përpunimin dhe organizimin e shitjes së produkteve bujqësore dhe të peshkimit
- 2** Ripërdorimi, ruajtja, përmirësimi i ekosistemeve
Masat agro-mjedisore dhe bujqësia organike
Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve
- 3** Promovimi i përfshirjes socio-ekonomike
Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i bizneseve
Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER
- 4** Transferimi i inovacioneve, njohurive
Përmirësimi i trajnimit
Shërbimet këshilluese
Ndihma teknike

¹ Programi i zhvillimit rural dhe bujqësor 2014-2020

Skemat mbështetëse vendore të zbatuara nga MBPZHR janë të ndara në 2 grupe:

i) pagesat direkte (programi i subvencionit) për të mbështetur drejtpërdrejtë të hyrat e fermerëve, dhe

ii) masat e zhvillimit rural (programet e granteve) siç është mbështetja e investimeve.

Masat e mbështetura në kuadër të PZhrB-së 2014-2020 janë në koherencë të plotë me programin IPARD të financuar nga BE për mbështetjen e vendeve kandidate dhe para-kandidate për zhvillimin dhe forcimin e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, në mënyrë që të jenë më konkurrues në tregun e BE-së. Përgatitja e PZhrB-së është në koherencë të plotë dhe me udhëzimin IPARD 2014-2020, duke iu përshtatur nevojave aktuale të vendit.

Për më tepër, PZhrB i nënshtrohet tre vlerësimeve kryesore, vlerësimit ex-ante, vlerësimeve të ndërmjetme dhe vlerësimit ex-post. Vlerësimi ex-ante ka si qëllim të vlerësoj cilësinë e programit ndërsa vlerësimet ndërmjetme dhe vlerësimi ex-post kanë si qëllim vlerësimin e zbatimit të tij.²

“Programi aktual është i bazuar në nevojat e vendit dhe mund të thuhet që ka qëllime strategjike, edhe pse si qëllim mund të mos jetë aq gjithëpërfshirës sa të targetoj kultura specifike që konsiderohen me interes kombëtar për Kosovën”.

Bazuar në këto të dhëna, palët e interesit konsideruan që ekziston një hapësirë e madhe për të përmirësuar analizën e sektorit në të cilin bazohen vendime të rëndësishme strategjike. Ata sugjerojnë se në analizat e ardhshme të sektorit, një rëndësi e madhe duhet t'i kushtohet identifikimit të interesave strategjike të Kosovës për produktet dhe kulturat specifike. Kosova duhet të

2 Programi i zhvillimit rural dhe bujqësor 2014-2020

identifikoj kulturat të cilat janë me interes kombëtar për te, për të zëvendësuar importin me produkte vendore, në rastet kur produktet vendore do të ishin më të lira dhe do të kontribuonin në zhvillimin e ekonomisë vendore. Veç kësaj, përmes një analizë më gjithëpërfshirëse të trendeve të tregut ndërkombëtar, Kosova duhet të identifikoj përparësitë e saja konkurruese dhe të fokusohet në kultivimin e kulturave për të cilat do të mund të ishte konkurruese në tregjet ndërkombëtare. Palët e interesit gjithashtu konsiderojnë se analizat duhet të llogarisin kapacitetet njerëzore dhe logjistike, pasi që ato definojnë politikat për zhvillimin e bujqësisë.

Për shkak të nivelit të ulët të prodhimit vendor, Kosova veçohet me bilanc negativ tregtar jashtëzakonisht të lartë. Në vitin 2017, Kosova ka importuar në total 3 miliardë euro ndërsa ka eksportuar vetëm 378 milionë euro. Një skenar i ngjashëm vërehet gjithashtu edhe në sektorin e frutave dhe perimeve. Në vitin 2017, Kosova ka importuar fruta dhe perime në vlerë prej 44 milionë euro dhe ka eksportuar vetëm 10 milionë euro.³ Në po këtë vit, Kosova ka importuar perime në vlerë prej 38 milionë euro dhe ka eksportuar vetëm 10 milionë euro. Prandaj, ka hapësirë të madhe për dizajnimin e politikave të cilat mund të ndihmojnë zëvendësimin e importit me produktet vendore, si dhe rritjen e eksporteve të produkteve strategjike të kërkuara nga tregjet ndërkombëtare.

3 Agjencia e Statistikave të Kosovës.

Përfshirja e palëve të interesit dhe shoqatave në politikë-bërje

Të gjitha palët e interesit, duke përfshirë ekspertë dhe përfaqësues të bizneseve të sektorit të bujqësisë në Kosovë, janë shumë aktivë dhe të gatshëm për të dedikuar kohën e tyre për të marrë pjesë në grupe punuese në lidhje me ndryshimin e politikave që mund të jenë të iniciuara nga autoritetet vendore ose organizatat ndërkombëtare. Të gjitha këto palë deklaruan se shpenzojnë shumë energji duke ofruar mendimin e tyre, megjithatë ata shpesh as që informohen për rezultatet e dala nga grupet punuese nga ku mblidhen rekomandimet. Sugjerimet e tyre nuk janë ndjekur dhe ata nuk janë informuar për arsyet se përse ato nuk zbatohen plotësisht. Ata konsiderojnë se MBPZHR ka komunikim në vetëm një drejtim në raport me grupet e interesit të sektorit të bujqësisë në Kosovë. Disa organizata të shoqërisë civile që merren me zhvillim rural preferojnë të mos marrin pjesë në grupe punuese pikërisht për shkak të kësaj qasjeje të MBPZHR-së.

Shumë shoqata që punojnë drejt përmirësimit të sektorit të bujqësisë në Kosovë janë përmendur gjatë diskutimeve dhe intervistave. Sipas palëve të interesit, janë të nevojshme shumë përmirësime në këtë sektor. Bazuar në këto të dhëna, është menduar se disa shoqata duhet të përfaqësojnë interesin e sektorit dhe jo bizneseve të veçanta që punojnë në këta sektorë. Ata gjithashtu deklaruan se disa nga këto shoqata janë krijuar nga një grup i kompanive me qëllim që të punojnë për interesat e tyre, në vend që të avancojnë interesa e nën-sektorit të caktuar.


Edhe pse shoqatat hasin në kritika, fakti që disa nga to kanë ndikuar fuqishëm në ndryshimin e ligjeve dhe rregulloreve në Kosovë u theksua nga një numër i madh i palëve të interesit. Kjo ishte edhe arsyeja pse shumica e palëve të interesit mendojnë se është e rëndësishme që këto shoqata duhet të kenë ndikim në sektorë.

Sipas MBPZHR-së, ekziston nevoja e krijimit të një bashkësie shoqatash, sipas standardeve të BE-së, njësoj si në shumë vende të tjera të botës. Këto rrjete mund të jenë shumë funksionale, pasi ato janë të organizuara në atë mënyrë që të përfaqësojnë kërkesat e fermerëve dhe të gjithë sektorit bujqësorë, dhe të jetë si pika kryesore e kontaktit për MBPZHR-në.

Pjesa 2: Programi i subvencioneve

Subvencionet janë esenciale dhe me rëndësi të pamohueshme për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e prodhimtarisë së kulturave të ndryshme bujqësore. Siç u potencua dhe më lartë, programi i subvencioneve e ka rritur në mënyrë të konsiderueshme buxhetin nga 8 milionë euro sa ishte në vitin 2007, në 24 milionë euro në vitin 2017, gjë e cila reflekton përpjekjet e politikë-bërësve kosovar që sektorit të bujqësisë t'i jepet prioritet në nivel të politikës nacionale.

Që nga projektimi i programit të zhvillimit rural dhe bujqësor 2014-2020, buxheti ka arritur një pikë të qëndrueshme, ku shpërndarja e tij është afërsisht e njëjtë për çdo vit, me rreth 25 milionë euro për secilin vit në tre vitet e fundit.



Grafik 2: Pagesat direkte nëpër vite

Burimi: Raporti i gjelbër, 2018

Nëse analizojmë shpërndarjen e buxhetit ndërmjet nën-sektorëve, shohim se sektori i drithërave dhe ai i gjedheve janë nën-sektorët me pagesat më të larta. Përderisa për të gjithë nën-sektorët ekziston një rritje e qëndrueshme e buxhetit ndër vite, ulje të buxhetit ka pasur vetëm në nën-sektorin e drithërave në vitin 2017, ku buxheti është ulur në 9.3 milionë euro, nga 10 milionë sa ishte në vitin 2016.

Është e rëndësishme të potencohet se prodhimi i produkteve organike në Kosovë është ende në zhvillim e sipër. Ligji për bujqësinë organike ka hyrë në fuqi në fund të vitit 2007. Më pas, është rishikuar dhe aprovuar ligji i ri në vitin 2012, i cili në pjesën më të madhe të tij është në linjë me rregulloret e BE-së për bujqësi organike⁴. Më gjithë këtë, edhe pse bujqësia organike ka filluar të subvencionohet tek në vitin 2016, buxheti për këtë nën-sektor pothuajse është trefishuar nga viti 2017 deri në buxhetin e planifikuar për vitin 2018.

	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018*
	EURO						
Drithëra	4,469,284	6,872,455	6,976,181	9,258,894	10,641,057	9,278,447	9,700,000
Perime	-	-	1,026,735	1,564,692	1,981,617	2,224,228	1,700,000
Fruta	-	1,220,780	2,366,574	2,836,945	3,306,943	3,989,214	3,500,000
Bujqësia organike	-	-	-	-	14,626	35,373	100,000
Gjedhet	2,104,800	2,105,950	2,703,634	4,505,154	5,708,599	6,508,459	5,375,000
Dele dhe dhi	1,327,450	1,159,720	1,210,120	1,921,365	1,933,245	2,112,810	1,850,000

Table 3: Direct Payments by sectors * Buxheti i planifikuar
Burimi: Raporti i gjelbër, 2018

Për më tepër, nëse analizojmë buxhetin e subvencioneve për sa i përket mbështetjes së lidhur me rezultate të prodhimit ose rendimentit, vërejmë shifra që reflektojnë problemet potenciale në sektorin e bujqësisë. Duke marrë parasysh që para vitit 2014 nuk kishte ndonjë program kombëtar dhe se rezultatet e sektorit para këtij viti nuk janë bazuar në një strategji gjithëpërfshirëse, përqendrimi jonë fokusohet vetëm në shifrat e vitit 2014 e tutje.

Për shembull, përderisa prodhimi i drithërave ka mbetur në të njëjtin nivel nga viti 2014 deri në vitin 2017, niveli i subvencioneve është rritur nga 15 euro për tonelatë, sa ishte në vitin 2014, në 19 euro për tonelatë në vitin 2017. Kjo nënkupton se subvencionet në nën-sektorin e drithërave nuk kanë pasur ndikim në rritjen e prodhimit dhe rendimentit të këtij nën-sektori, përkundrazi, ai vetëm subvencionon një pjesë më të madhe të shpenzimeve për prodhimin e sasisë së njëjtë të të korrurave. Kur e analizojmë

⁴ Programi i zhvillimit rural dhe bujqësor 2014-2020

këtë nga perspektiva që subvencionet duhet të sigurojnë qëndrueshmëri dhe stabilitet në bujqësi, mund të pranojmë rezultatin e mësipërm pasi që programi i subvencioneve mund të ketë arritur rolin e tij në qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e kësaj kulture. Sidoqoftë, duke pasur parasysh rritjen e ndjeshme të buxhetit të subvencioneve me 33% nga viti 2014 në vitin 2017, mund të thuhet gjithashtu se janë pritur rezultate më të larta të prodhimit dhe rendimentit në këtë nën-sektor.

	2012	2013	2014	2015	2016	2017
Subvencionet për drithëra (Euro)	4,469,284	6,872,455	6,976,181	9,258,894	10,641,057	9,278,447
Prodhimi i drithërave (ton)	438,792	540,136	463,581	443,584	562,899	477,880
Raporti EUR/ton	10.2	12.7	15.0	20.9	18.9	19.4
Subvencionet për perime (Euro)			1,026,735	1,564,692	1,981,617	2,224,228
Prodhimi i perimeve (ton)			221,330	246,096	335,467	358,394
Raporti EUR/ton			4.6	6.4	5.9	6.2
Subvencionet për fruta (Euro)		1,220,780	2,366,574	2,836,945	3,306,943	3,989,214
Prodhimi i fruta (ton)		76,702	45,873	70,096	78,502	49,571
Raporti EUR/ton		15.9	51.6	40.5	42.1	80.5
Subvencionet për gjedhe (Euros)	2,104,800	2,105,950	2,703,634	4,505,154	5,708,599	6,508,459
Kultivimi i gjedheve (kokë)	329,213	321,113	261,689	258,504	264,971	259,729
Raporti EUR/ton	6.4	6.6	10.3	17.4	21.5	25.1
Subvencionet për dele dhe dhi (Euros)	1,327,450	1,159,720	1,210,120	1,921,365	1,933,245	2,112,810
Kultivimi i deleve dhe dhive (kokë)	247,901	216,577	212,014	224,096	212,040	210,688
Raporti EUR/ton	5.4	5.4	5.7	8.6	9.1	10.0

Tabela 4: Subvencionet dhe prodhimi sipas kulturave
Burimi: Raporti i gjelbër, 2018

Rezultate të ngjashme janë vërejtur edhe në nën-sektorët e tjerë. Niveli i subvencioneve për nën-sektorin e perimtarisë është rritur nga 4.6 euro për tonelatë në vitin 2014, në 6.2 euro për tonelatë në vitin 2017, përderisa në sektorin e frutave niveli i subvencioneve është rritur nga 52 euro për tonelatë në vitin 2014 në 81 euro për tonelatë në vitin 2017. Për gjedhe, niveli i subvencioneve është rritur nga 10 euro për kokë bagëtie në 25 euro për kokë bagëtie dhe për dele e dhi nga 6 euro për kokë bagëtie në 10 euro për kokë bagëtie.

Dizajnimi i programit të subvencioneve

Në vitin 2017, Komisioni Evropian publikoi një raport mbi politikën e zhvillimit të bujqësisë. Ata prezantuan të gjeturat e tyre në zbatimin e pagesave të subvencioneve në shtetet e Ballkanit Perëndimor ndërmjet viteve 2010 dhe 2015.

Në bazë të të dhënave të tabelës të prezantuara në raport, shtetet si Kosova dhe Mali i Zi kanë pasur ndryshime të vogla sa i përket skemës mbështetëse, përderisa vendi me ndryshimet më të mëdha në skemën mbështetëse gjatë periudhës ndërmjet viteve 2010 dhe 2015 është Shqipëria.

Kosova është vendi i vetëm i cili ka shumicën e planit mbështetës buxhetor të ndarë në pagesa direkte bazuar në sipërfaqe poseduese aktuale apo për kokë bagëtie. Në periudhën kohore 2010-2012 një përqindje e vogël e buxhetit është ndarë në formë të subvencionimit të inputeve të ndryshueshme, e cila është zvogëluar me kalimin e viteve dhe përfundimisht është larguar nga skema e mbështetjes në vitin 2013. Pagesat direkte bazuar në prodhim kanë filluar të zbatohen nga viti 2014, dhe vazhdojnë ende të aplikohen në formë të pagesave direkte megjithëse në përqindje më të vogël.

Vendi i dytë pas Kosovës që ka shumicën e planit mbështetës buxhetor të ndarë në pagesa direkte bazuar në sipërfaqe poseduese aktuale apo për kokë bagëtie është Mali i Zi. Ky vend gjithashtu ka pasur më së paku ndryshime në skemën mbështetëse. Ata përdorin tri forma të pagesave direkte, pagesat bazuar në sipërfaqe/kokë bagëtie, pagesat bazuar në produktivitet (mbështetje e çmimeve) dhe subvencionimin e inputeve të ndryshueshme. Kjo e fundit është forma që përdoret më së paku.

Në Shqipëri në vitin 2010, pagesat direkte janë bërë vetëm në dy forma, 60% bazuar në produktivitet dhe 40% bazuar në sipërfaqe/kokë bagëtie, e cila formë në vitin 2011 arriti deri në 60%, përderisa forma bazuar në produktivitet ra në 40%. Megjithatë, në vitin 2012 u bënë ndryshime rrënjësore, ku pothuajse i tërë buxheti për mbështetje direkte është ndarë në një formë të pagesave dhe atë bazuar në sipërfaqe/kokë bagëtie. Ndryshimet në skemën mbështetëse vazhduan në vitet pasuese, megjithatë pagesat direkte bazuar në sipërfaqe/kokë bagëtie mbeti forma kryesore e

pagesave në skemën mbështetës përgjatë viteve 2013 deri 2015, duke ndarë buxhetin total edhe me dy forma tjera të pagesave; si pagesa direkte në bazë të produktivitetit dhe subvencionim i inuteve të ndryshueshme. Përqindja e buxhetit të ndarë për pagesa direkte bazuar në sipërfaqen/kokë subvencionimit të inuteve të ndryshueshme bagëtie nuk ka ndërruar përgjatë viteve 2013 deri në 2015 (rreth 70%), ndërsa për dy format e tjera, buxheti ka ndërruar përgjatë viteve duke u rritur për njërin dhe zvogëluar për tjetrën.

Në vitin 2010, Maqedonia e veriut pothuajse në mënyrë të barabartë e kishte ndarë buxhetin për pagesa direkte në mes të formës bazuar në sipërfaqe/kokë bagëtie dhe formës së bazuar në produktivitet. Në vitin 2011, pagesat direkte bazuar në sipërfaqen/kokë bagëtie u rritën deri në 70%, për të rënë në vitin 2012 në 40%, duke vazhduar rënien edhe për 20% në vitin 2013. Në vitin 2014, pagesat bazuar në produktivitet u rritën përsëri, megjithatë përqindja më e madhe e buxhetit ishte ndarë për pagesat bazuar në sipërfaqen/kokë bagëtie, gjë e cila ndryshoi përsëri në vitin 2015. Në po të njëjtin vit, më shumë se 10% e buxhetit ishte shpenzuar për kompensim të fatkeqësive dhe kompensime të tjera për prodhuesit.






Sa i përket vendeve fqinje, Bosnja dhe Hercegovina është i vetmi vend që ka pasur dhe ende ka shumicën e buxhetit (60% në vitin 2015) të ndarë për formën e pagesës në bazë të produktivitetit. Në vitin 2011, pagesa në formë të subvencionimit të inuteve të ndryshueshme ishte shtuar në skemën mbështetëse me rreth 20% të buxhetit, përqindje e cila u zvogëluar në vitet pasuese.

Serbia në vitin 2010 dhe 2011, kishte shumicën e buxhetit të ndarë për pagesa në bazë të formës së subvencionimit të inuteve të ndryshueshme. Kjo ndryshoi në vitin 2012 ku shumica e buxhetit u nda për pagesë në baze të sipërfaqes/kokë bagëtie dhe vazhdoi kështu në vitet në vazhdim (50% në vitin 2015). Në dy vitet e fundit, pjesa tjetër prej 50% e skemës mbështetëse të buxhetit është ndarë për pagesa në formë të subvencionimit të inuteve të ndryshueshme (30% në vitin 2015) dhe në bazë të produktivitetit (20% në vitin 2015).

Programi aktual i subvencioneve në Kosovë në shumë raste keqkuptohet dhe nuk interpretohet si duhet nga përfaqësuesit e MBPZHR-së. Ky program ka disa forma të subvencionimit të bazuara në inpute dhe outpute varësisht nga kulturat; mirëpo aktualisht programi konsiderohet i sheshtë dhe i bazuar vetëm në inpute. Për më tepër, të gjithë palët e interesit, që ishin pjesë e këtij studimi, u pajtuan që ka nevojë për të sqaruar para publikut se qëllimi i programit të subvencioneve është sigurimi i qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sektorit të bujqësisë e jo i zhvillimit të ndonjë nën-sektori specifik. Zhvillimi i nën-sektorëve mbështetet nga programet e granteve, jo vetëm nga buxheti shtetëror por edhe nga donatorët ndërkombëtar. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se programi i subvencionimit nuk mund të mbështes ose zhvilloj këta nën-sektorë, duke promovuar para së gjithash, stabilitetin dhe qëndrueshmërinë e po këtyre nën-sektorëve.

Të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe MBPZHR-në, pajtohen që ka hapësirë për përmirësim dhe zhvillimin, ose për një reformë në programin dhe politikën e subvencioneve. Shumica e palëve të interesit pajtohen që programi aktual i subvencioneve ka mungesë të strategjisë dhe fokusit në produkte specifike dhe i njëjti duhet t'i përshtatet rrethanave në mënyrë që të siguroj zhvillim si dhe drejtësi.

Disa palë të interesit madje besojnë se skema aktuale për subvencione nuk mbështetet nga një orientim strategjik ndaj disa produkteve të identifikuar si strategjike nga analizat sektoriale. Për rrjedhojë, ata konsiderojnë se masat mbështetëse nuk janë të drejta dhe janë të ndikuara politikisht për të mbështetur grupet e interesit të afërta me partitë politike që janë në pushtet. Si ilustrim, rrushi është subvencionuar me një sasi të konsiderueshme mjetesh, edhe pse nuk është i përcaktuar si një produkt strategjik për Kosovën. Për më tepër, edhe vera gjithashtu subvencionohet, e cila sipas grupeve të interesit paraqet një përkrahje të dyfishtë, efekti i së cilës duhet të matet dhe ndryshohet në qoftë se nuk arrihen rezultatet e dëshiruara. Ndikimi i subvencionimit për një kulturë të veçantë duhet të matet përgjatë një periudhe të caktuar kohore, dhe nëse nuk arrihet ndikimi i synuar në këtë kulturë, atëherë subvencionimi duhet të



- Pagesat direkte në bazë të output-eve
- Pagesat direkte në bazë të hapësirës aktuale / kafshëve
- Variabli i subvencioneve për input.
- Të ndryshme.
- Pagesat për katastrofa dhe kompensimet e tjera për prodhues
- Totali për hektarë (shkalla e duhur)

bëhet për një kulturë tjetër.

Një tjetër çështje e kyçe se përse disa biznese besojnë se programi aktual i subvencionimit nuk është i drejtë, ka të bëjë me atë se i njëjti nuk është i orientuar drejt nivelit të prodhimit dhe outputit, dhe se programi mbështetë fermerët të cilët nuk punojnë në mënyrë të duhur. Sipas tyre, subvencionimi në bazë të produktivitetit do të mbështeste dhe inkurajonte fermerët që realisht punojnë. Për shembull, edhe pse sipërfaqet e mbjella me kunguj ishin subvencionuar, niveli i prodhimit në shumë raste ka qenë afër zeros.

Sipas palëve të interesit, subvencionet duhet të shpërndahen në dy nivele. Niveli i parë ka të bëjë me një mbështetje në vlerë minimale që do të subvenciononte të gjithë tokën bujqësore që kultivohet. Subvencioni i nivelit sekondar vlen për produktet strategjike - për shembull, nëse thekra nuk është një produkt strategjik, atëherë kualifikohet vetëm për subvencion të nivelit të parë, dhe nëse mjedra është një produkt strategjik, ai merr nivelin e parë dhe të dytë të subvencionit. Niveli i parë duhet të subvencionohet në varësi të sipërfaqes së kultivuar, ndërsa niveli i dytë duhet të përcaktohet në bazë të kapaciteteve të AZHB-së, dhe mund të subvencionohet bazuar në sipërfaqen e kultivuar ose për njësi të prodhimit (d.m.th. kilogram).

Një numër shoqatash tashmë po llobojnë me MBPZHR-në me qëllim të zbatimit të subvencioneve bazuar në prodhim në sektorët që ata përfaqësojnë. Arsyet kryesore për mbështetjen e kësaj qasje është se kjo metodë mund të inkurajoj fermerët e vërtetë për të punuar. Aktualisht, ka shumë hektarë të mbjella dhe kategori fermerësh të cilët nuk tentojnë të rrisin produktivitetin e tyre dhe akoma marrin subvencione, në krahasim me fermerët të cilët punojnë më shumë (prodhojnë më shumë), dhe përsëri përfitojnë të njëjtin nivel të subvencioneve. Kjo gjithashtu do të ndihmojë fermerët të cilët prodhojnë në sasi të kufizuar hektarësh, dhe që nuk janë të përfshirë në shumë programe subvencionesh sepse nuk plotësojnë standardet minimale.

Sipas palëve të interesit, subvencionet e çiftëzuara gjithashtu do të mund të mbështesin dhe mbrojnë fermerët nga kushtet e pafavorshme klimatike si thatësira dhe breshëri; por edhe në rastet

e paqëndrueshmërisë së kurseve të këmbimit të çmimeve, e raste tjera të ngjashme. Një metodë e tillë siguron qëndrueshmëri ndaj ndryshimeve klimatike apo ndryshimeve të çmimeve. Kroacia është një shembull shumë i mirë i mbështetjes përmes këtij lloji të subvencionimit, e cila e ka zbatuar me sukses këtë qasje.

Është gjithashtu e qartë se programet e propozuara të subvencionimit nuk mund të aplikohen për të gjitha kulturat për shkak të vështirësive në procesin e zbatimit dhe monitorimit. Për shembull, subvencionimi i perimtarisë në bazë të nivelit të prodhimit mund të jetë problematik për shkak të shitjeve jo-formale dhe mungesës së qendrave grumbulluese; prandaj është e vështirë të gjinden mekanizmat e duhur që të zbatohen plotësisht. Zbatimi i subvencioneve në bazë të nivelit të prodhimit në të gjitha kulturat duhet të planifikohet dhe zbatohet me kujdes. Një gjë e tillë duhet të zbatohet vetëm në rastet e atyre kulturave të cilat mund të gjurmohen ose përlllogariten nëpër gjithë zinxhirin e vlerës. Në këtë mënyrë, ky program mund të vlerësoj me vërtetësi shumë e cila duhet të subvencionohet si dhe ka më pak mundësi për keqpërdorim dhe mashtrim.

Dhe së fundi por jo për nga rëndësia, rajonalizimi i bazuar në historikun e prodhimit dhe përparësitë klimatike duhet të merret parasysh gjatë reformimit të skemës së subvencioneve. Prandaj, subvencionet të cilat vijnë nga buxhetet e komunave duhet të jenë në përputhje me mbështetjen qendrore dhe gjithashtu duhet të shërbejnë drejt qëllimit të mbylljes së ciklit të zinxhirit të vlerës.

Pjesa 3: Masat e zhvillimit rural

Masat e zhvillimit rural ose programi i granteve nga MBPZHR është program paralel me programin e subvencioneve, qëllimi i të cilit është të nxisë dhe mbështesë zhvillimin e sektorit të bujqësisë në Kosovë. Masat e zhvillimit rural janë të rregulluara nga programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural 2014-2020. Ky program ka filluar në vitin 2014 dhe kjo paraqet edhe periudhën kur ka filluar investimi i vërtetë në zbatimin e programit. Para kësaj periudhe, mbështetja ishte kryesisht në vlera të vogla dhe nuk ishte e organizuar e adaptuar me programin IPARD sipas standardeve të BE-së.

Buxheti vjetor aktual, siç është planifikuar në buxhetin e vitit 2018, për masat e zhvillimit rural është afërsisht 22 milionë euro. E njëjta shumë buxhetore është ndarë edhe për programin e granteve nga MBPZHR në vitet e fundit, përveç vitit 2014 kur kishte 417 aplikacione të aprovuara, shuma e të cilave ishte afërsisht 16 milionë euro. MBPZHR nuk ka dhënë ndonjë arsye në lidhje me uljen buxhetore për vitin 2017 në raportin e tyre vjetor.




Figura 5. Masat e zhvillimit rural

Burimi: Raporti i gjelbër, 2018

Në programin e zhvillimit rural fillimisht ishin paraparë 9 masa siç janë përshkruar edhe në tabelën në vijim, megjithatë, vetëm katër masa nga kjo listë kanë filluar dhe kanë vazhduar të zbatohen që nga viti 2014, përderisa në vitin 2015 është shtuar edhe masa për ujitjen e tokave bujqësore.

Masa (2014-2020)		Viti fillestar
101	Investimet në asete fizike në ekonomitë bujqësore	2014
103	Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	2014
201	Masat agro-mjedisore dhe bujqësia organike	-
202	Krijimi dhe mbrojtja e pyjeve	-
302	Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit	2014
303	Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER	2014
401	Përmirësimi i trajnimit	-
402	Shërbimet këshilluese	-
501	Ndihma teknike	-
NN	Ujitja e tokave bujqësore	2015

Tabela 5. Masat e planifikuara në programin e zhvillimit rural
Burimi: Programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural 2014-2020

Pjesa më e madhe e buxhetit për masat e zhvillimit rural janë shpërndarë në investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore, e ndjekur nga investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore. Për shembull, buxheti i planifikuar për vitin 2018 ka paraparë të shpërndajë 66% të mjeteve në investimet në asetet fizike të ekonomive bujqësore, 22% në investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, 9% në diversifikimin e fermës dhe zhvillimin e biznesit dhe nga 2% për zbatimin e strategjisë lokale për zhvillim – përmes qasjes LEADER dhe në ujitje të tokave bujqësore.

Nuk ka pasur ndryshime të mëdha nga viti në vit sa i përket shpërndarjes së buxhetit të përgjithshëm në masa specifike. Vetëm në vitin 2017, masa 103 kishte një numër të vogël të aplikimeve (N=5), duke përfunduar kështu me një shumë të vogël të pagesave të aprovuara.

Masa (2014-2020)		2014	2015	2016	2017	2018*
		EUR				
101	Investimet në asete fizike në ekonomitë bujqësore	5,250,000	11,000,000	15,234,339	12,790,578	12,000,000
103	Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	3,000,000	5,000,000	4,661,782	959,024	4,000,000
302	Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit	900,000	1,500,000	1,561,820	1,632,494	1,700,000
303	Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER	-	90,480	79,850	-	300,000
NN	Ujitja e tokave bujqësore	-	90,480	79,850	64,871	300,000

Tabela 6. Masa e zhvillimit rural ndër vite
Burimi: Raporti i gjelbër, 2018

* Buxheti i planifikuar

Programi i granteve i MBPZHR-së funksionon në atë mënyrë që grantet e dhëna nga sektori publik duhet të shoqërohen me investimet nga sektori privat. Edhe vendet e Ballkanit ndjekin të njëjtën metodë për shpërndarjen e buxhetit. Kontributi është i ndarë në mes të sektorëve, atij publik dhe privat, me përqindje të ndryshme që duhet të mbulohet nga buxheti për secilën masë.

Tri masat kryesore, të zbatuara në këto pesë shtete, janë investimet në asetet fizike në ekonomitë bujqësore me 60% nga kontributi publik dhe 40% nga ai privat; investimet në asetet fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore, për të cilën masë kontributi është i barabartë në raport 50/50 ndërmjet sektorit publik dhe atij privat; dhe diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit me kontribut prej 65% të sektorit publik dhe 35% të atij privat.

Siç mund të shihet në tabelën vijuese, Kosova nuk zbaton disa nga masat që vendet fqinje (jo medoemos të gjitha prej tyre) tashmë veçse i zbatojnë, dhe se aplikon një masë që asnjëra nga to nuk e zbaton, atë të ujitjes së tokave bujqësore, për të cilën kontributi publik është 80%.

Mali i Zi është vendi i vetëm me numrin më të madh të masave të zbatuara, e ndjekur nga Serbia, ndërkaq Shqipëria zbaton vetëm katër masa..

Kontributi	Kosova		Shqipëria		Serbia		Maqedonia		Mali i zi	
	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat	Publik	Privat
Investimet në asete fizike në ekonomitë bujqësore	60%	40%	60%	40%	60%	40%	60%	40%	60%	40%
Investimet në asete fizike në përpunimin dhe tregtimin e produkteve bujqësore	50%	50%	50%	50%	50%	50%	50%	50%	50%	50%
Diversifikimi i fermës dhe zhvillimi i biznesit	65%	35%	65%	35%	65%	35%	65%	35%	65%	35%
Masat agro-mjedisore dhe bujqësia organike	-	-	-	-	100%	0%	-	-	100%	0%
Zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal - qasja LEADER	100%	0%	-	-	100%	0%	-	-	100%	0%
Investimet në infrastrukturën rurale	-	-	-	-	-	-	100%	0%	100%	0%
Ndihma teknike	-	-	100%	0%	100%	0%	100%	0%	100%	0%
Ujitja e tokave bujqësore	80%	20%	-	-	-	-	-	-	-	-

Tab 7. Rural Development Measure Contributions

Burimi: Programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural 2014-2020

Shqipëri - Programi i zhvillimit rural 2014-2020

Serbia - Programi IPARD për vitet 2014-2020

Maqedoni - Programi IPA i zhvillimit rural 2014-2020

Mali i Zi - Programi për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në Mal të Zi nën IPARD II 2014-2020

Sipas palëve të interesit, skema aktuale e granteve po funksionon shumë mirë, megjithatë matja e efekteve dhe veçanërisht procesi i monitorimit kërkon përmirësim. Këto të fundit vijnë si pasojë e kapaciteteve të kufizuara të AZHB-së. Edhe pse AZHB ka procedura dhe manuale, ato gjejnë zbatim të vogël gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit.

Një çështje e rëndësishme që, sipas palëve të interesit, kërkon adoptim është fakti që grantet akordohen për periudha të afatshkurtra - nga 1 deri në maksimum 2 vjet. Kjo, sipas palëve të interesit, nuk siguron zhvillim të qëndrueshëm të bizneseve dhe si pasojë as të sektorit të bujqësisë. Skema aktuale e shpërndarjes së garantëve vjetore, sipas palëve të interesit, i shtynë bizneset të

përqendrohet në përfitimin e granteve pa u fokusuar në zhvillimin e biznesit paraprakisht.

Programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural përmban kërkesat e përgjithshme për pagesat e granteve, të cilat më vonë mund të ndryshojnë në përshkrimin e masës varësisht kërkesave të tij. Projekti fillon të zbatohet pasi kontrata e bashkëfinancimit të jetë nënshkruar, dhe mund të zgjasë deri në dy vjet, varësisht specifikave të investimit.

Bujqit mund të aplikojnë për masa të ndryshme, mirëpo në të njëjtën masë lejohet të aplikojnë vetëm një herë brenda një afati/thirrjeje për aplikim. Investimi, për të cilin përfituesi fiton përkrahjen financiare, nuk duhet t'i nënshtrohet ndonjë ndryshimi brenda 5 viteve nga data e pranimit të pagesës përfundimtare. Të gjitha projektet e mbështetura nga programi i zhvillimit rural i nënshtrohen kontrollit 'ex-post' për një periudhë 5 vjeçare.⁵

Një tjetër çështje e ngritur është edhe fakti se grantet zakonisht përkrahin bizneset të cilat blejnë makineri të ndryshme për prodhim të pajisura me teknologji të re. Një gjë e tillë duhet të kontrollohet me kujdes duke pasur parasysh arsyeshmërinë e prodhimit dhe nëse një investimi i tillë shërben drejt qëllimit të përmbylljes ose kompletimit të zinxhirit të vlerës. Disa nga makineritë e blera nga grantet jo domosdoshmërisht rrisin kapacitetet prodhuese, megjithatë ato rrisin cilësinë e prodhimit dhe janë më ekologjike në shumicën e rasteve.

Për më tepër, shumica e palëve të interesit, përveç përfaqësuesve qeveritarë, u pajtuan që grantet për ndërtimin e objekteve të reja duhet të jenë të kufizuara, për shkak se ato duhet të jenë më të fokusuara në rritjen e kapaciteteve prodhuese.

Shërbimet këshilluese, trajnimet dhe konsultimet

Departamenti i shërbimeve këshilluese në MBPZHR koordinon aktivitetet në nivel qendror dhe lokal duke mbështetur dhe ofruar këshilla dhe trajnime. Aktivitetet e shërbimeve këshilluese të zhvilluara në qendrat këshilluese komunale të informacionit janë organizuar për të mbështetur fermerët përmes këshillave teknike në

⁵ Programi i bujqësisë dhe zhvillimit rural 2014-2020.

sektorët e blegtorisë, bletarisë, vreshtarisë, abrokulturës dhe perimeve.

Grupet Lokale të Veprimit (GLV) janë krijuar me financim të BE-së, dhe përbëhen nga 25 anëtarë. Pjesëmarrja në këto grupe është në raport prej 50:50 ndërmjet personave dhe organizatave të sektorit publik ose privat. Krahas GLV-ve, është krijuar edhe rrjeti i zhvillimit rural të Kosovës që lidhë 30 GLV-të, me qëllim që të kontribuoj në zhvillimin ekonomik të zonave rurale duke ofruar mbështetje për komunitetet lokale në zbatimin e strategjive lokale të zhvillimit. Rrjeti shërben si një platformë për diskutimin e ideve, propozimeve të ndryshme, sigurimin e asistencës teknike dhe shkëmbimin e përvojave ndërmjet GLV-ve.

Si pjesë e programit për zhvillimin rural ekziston edhe një masë e dedikuar për funksionalizimin dhe zbatimin e strategjive të mbështetjes së zhvillimit.

Aktiviteti i parë, përvetësimi i aftësive dhe promovimi/gjallërimi i banorëve në zonat e GLV-ve të përzgjedhura, është zbatuar dhe tani janë 12 zyra funksionale të GLV-ve që janë akredituar krahas rrjetit të zhvillimit rural të Kosovës. Menaxherët e këtyre zyrave janë përzgjedhur të cilët kanë zhvilluar aktivitetet e tyre bazuar në përshtetjen e punës. Shpenzimet operacionale të GLV-ve janë të lidhura me menaxhimin dhe funksionalizimin e GLV-ve sipas qasjes LEADER dhe fillimin e zbatimit të strategjive të zhvillimit lokal.

Aktiviteti i dytë 'zbatimi i strategjive të zhvillimit lokal', ka të bëjë me mbështetjen për zbatimin e strategjive të zhvillimit lokale të GLV-ve të përzgjedhura, në përputhje me të cilat GLV-të zbatojnë projekte të vogla. Aktivitetet e tilla mbështesin ngjarjet kulturore (panaie, ekspozita, festivale, etj.), promovimin e produkteve lokale (etiketim, marketing, fletëpalosje, broshura, etj.), intervenime të vogla në infrastrukturë (gardhe, fontana, parqe, ura të vogla, shënjimi i rrugëve malore, rinovimi i trashëgimisë kulturore dhe natyrore, etj.).

Projektet dhe aktivitetet janë realizuar në bashkëpunim me donatorë dhe shoqata të ndryshme si: agjencia gjermane për bashkëpunim ndërkombëtar - GIZ, ADA austriake, Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë, Qendra Kosovare për Zhvillim, Besimi

islam, Fondacioni Kosovë-Luksemburg, Helvetas/ S4RE, Kujdesi dhe trajnimet e ofruara nga Resi me projektin iniciativa e qëndrueshmërisë ekonomike rurale, shoqata “Anamorava”, etj.⁶

Përkundër këtyre aktiviteteve dhe koordinimit të realizuar nga MBPZHR dhe agjencitë e saj, ekziston një pajtueshmëri e përgjithshme ndërmjet palëve të interesit se ka mungesë të konsulentëve profesional dhe shërbimeve këshilluese gjatë procesit të zbatimit të projekteve që financohen nga grantet. Fermerët nuk janë të arsimuar dhe trajnuar siç duhet, dhe përkundër trajnimeve që ofrohen nga akterët e ndryshëm, shërbimet këshilluese janë të domosdoshme për të siguruar kultivimin e duhur të kulturave bujqësore dhe zhvillimin e duhur të aftësive pas prodhimit dhe përpunimit, për të minimizuar gabimet. Shërbimet këshilluese profesionale janë gjithashtu të nevojshme për të ndihmuar fermerët dhe bizneset të ndërtojnë modele të shëndetshme të bizneseve, praktikat e qeverisjes korporative, si dhe strategjitë e suksesshme të shitjeve për tregjet vendore dhe ato ndërkombëtare.

Pjesa 4: Sistemi i informacionit dhe monitorimit

AZHB përdor disa programe, si Regjistri Elektronik i Fermerëve (REF), sistemi i thjeshtëzuar i identifikimit të parcelave të tokës (sLPIS), sLPIS-Mobil i cili përdoret për kontrollin e sipërfaqes në terren, regjistri i menaxhimit të pagesave direkte, programi për menaxhimin e granteve, programi i indikatorëve. Këto programe menaxhohen dhe mirëmbahen nga divizioni i teknologjisë së informacionit dhe regjistrimit, të cilët i kanë krijuar dhe u kanë dhënë qasje zyrtarëve të AZHB-së.

AZHB ka gjithashtu një sistem të monitorimit, në formë të një databaze të veçantë për indikatorë në sistemin e TI-së. Për të gjitha projektet e paraqitura, indikatorët duhet të përfshihen në databazë. Futja e të dhënave respekton parimin e katër syve - ku një ekspert fut të dhënat dhe një tjetër e bën verifikimin e tyre nga sistemi i TI-së, në krahasim me të dhënat nga dokumentet. Ndjekja e pavarur e indikatorëve të terrenit është paraparë nga donatorët e programit.

Zyrtarët e autoritetit menaxhues nga divizioni i monitorimit, vlerësimit dhe raportimit kanë qasje të drejtpërdrejtë në sistemin e TI-së për indikatorë, me mundësinë e transferimit të të dhënave në formate të ndryshme (Excel, pdf, etj.), dhe gjenerimin e raporteve duke u bazuar në kritere specifike, ose në përdorimin e ndonjë mjeti të përparuar të raportimit që bën gjenerimin e raporteve dhe grafikoneve në mënyrë automatike. Sistemi aktualisht përdoret që të transferoj indikatorët e projektit të granteve për feramat dhe përpunuesit nga skema kombëtare, duke pasur kështu aftësinë për të testuar më mirë sistemin, për të përmirësuar procedurat e brendshme dhe për të mundësuar stafin që të aftësohet.

Tema e sistemit të monitorimit është zhvilluar në partneritet me DANIDA-n, një donator me një rol të rëndësishëm në programin e zhvillimit rural, i cili ka shprehur një interes të veçantë në përcjelljen e rezultateve dhe ndikimin e zbatimit të programit.⁷

Sipas palëve të interesit, ka shumë hapësirë për përmirësimin e të dhënave statistikore. Duhet të përcaktohet një metodologji

⁷ Programi për zhvillimin e bujqësisë dhe atë rural 2014-2020

dhe procedura standarde për mbledhjen, përpunimin, vërtetimin dhe analizën e të dhënave në bazat e të dhënave të MBPZHR-së. Gjithashtu, metodologjia duhet të përfshijë të dhëna nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, si dhe të dhënat nga niveli lokal (komunat), në mënyrë që të dokumentojnë dhe menaxhojnë të gjitha të dhënat e sektorit, duke ofruar një tablo të qartë të sektorit të bujqësisë.

Sipas palëve të interesit, në mënyrë që të sigurojmë një tablo më të qartë, duhet të matet ndikimi përmes tri aspekteve:

- Rritjes së konsumit
- Rritjes së përpunimit dhe cilësisë së lëndës së parë
- Rritjes së produktivitetit

Bazuar në këto të dhëna, arrijmë në përfundim se informaliteti është pengesa kryesore e cila pengon mbledhjen e statistikave të cilat janë përfaqësuese në nivel të sektorit. Kjo nuk lejon të kemi një pamje reale rreth asaj se çka ndodh në realitet.

Një tjetër çështje që rezulton në mospërputhje në raportimin e të dhënave statistikore, është mungesa e saktë e kodeve të importit dhe eksportit të përdorura gjatë kontrolleve doganore. Gjithashtu, të dhëna statistikore nuk marrin parasysh ndikimet klimatike.

Sipas raportit të AZHB-së, të publikuar në vitin 2017, gjatë vitit 2016 agjencia u përball me shumë vështirësi dhe pengesa në realizimin e detyrave të saj për zhvillimin e aktiviteteve të planifikuara për zbatimin e programeve mbështetëse. Në vitin 2016, AZHB punësoi më shumë punëtorë me kontrata mbi vepër për të mundur përfundimin e këtyre aktiviteteve.

Një sfidë tjetër me të cilën vazhdon të përballlet AZHB-ja ishte dështimi për të marrë aprovimin për kërkesën e rritjes të buxhetit në kategorinë 'paga dhe mëditje' dhe 'mallra dhe shërbime'. AZHB edhe sot has në shumë pengesa, një ndër to është edhe mungesa e inspektorëve për kryerjen e kontrolleve për programin e zhvillimit rural dhe pagesave direkte. Numri i madh i çështjeve që kanë nevojë për kontrolle i pengon ata që t'i zbatojnë dhe kryejnë të dy kontrollet njëkohësisht.

Sa i përket programeve të pagesave direkte, AZHB ka raportuar se kishte problem në vitin 2016 me mbajtjen e kontrolleve për shkak të vonesave në përgatitjen e programit të pagesave direkte dhe shtyrjes së afatit për aplikim, i cili më vonë u bë një problem i vazhdueshëm. Një tjetër problem që duhet përmendur, dhe që vonon kryerjen e kontrolleve të programit të pagesave direkte, janë gabimet gjatë aplikimit të bëra nga fermerët dhe zyrtarët e pranimit të dokumentacionit.

Përfundimet dhe rekomandimet

5

Përfundimet dhe rekomandimet

Orientimi Strategjik

1 Përfundimi

Plani i zhvillimit të bujqësisë dhe atij rural përshkruan një strategji të gjerë me objektiva të përgjithshme rreth rritjes në sektorin agro-ushqimit, mbrojtjes së burimeve natyrore dhe mjedisit të zonave rurale, dhe përmirësimit të cilësisë së jetës dhe diversifikimit të mundësive dhe punësimit në zona rurale. Sidoqoftë, sektori i bujqësisë nuk ka një strategji të përqendruar në këta nën-sektorë, të bazuar në analizat e tregut për zëvendësim të importit apo rritje të eksportit. Për më tepër, edhe pse zhvillimi dhe dizajnimi i çdo programi vjetor është i bazuar në analizat sektoriale, dhe analizimin e zinxhirit të vlerës për çdo kulturë bujqësore, mbështetja me grante dhe subvencione nuk është i koordinuar si duhet në funksion të plotësimit ose përmbushjes së të gjitha pjesëve të zinxhirit të vlerës.

1 Rekomandimi

Kosova duhet të identifikojë kulturat që janë me interes kombëtar që Kosova të zëvendësojë importet me prodhimin vendor, në rastet kur i njëjti do të ishte më efikas në aspektin e kostove dhe të kontribuonte në zhvillimin e ekonomisë së vendit. Kosova gjithashtu duhet të identifikojë avantazhet e saja konkurruese dhe të përqendrohet në kultivimin e kulturave që mund të futen me konkurrencë në tregjet ndërkombëtare. Për më tepër, zinxhiri i vlerës duhet të analizohet në tërësi për të parë nëse të gjitha programet mbështetëse të MBPZHR, programet mbështetëse në nivelin lokal dhe programet mbështetëse të donatorëve të jashtëm po shërbejnë në drejtim të kompletimit të zinxhirit të vlerës. Gjithashtu, programet mbështetëse (subvencionet dhe grantet) duhet të koordinohen ndërmjet tyre për të kompletuar zinxhirin e vlerës.

2 Përfundimi

Politikat e zhvilluara nga MBPZHR-ja nuk merren parasysh seriozisht gjatë alokimit të Buxhetit të Kosovës.

2 Përfundimi

Rritja e veprimtarive efektive të avokimit me qeverinë dhe kuvendin e republikës së Kosovës (përfshirë komisionin parlamentar) për të bërë ndryshimet e nevojshme buxhetore që shërbejnë me qëllim të arritjes së qëllimeve dhe planeve të MBPZHR-së dhe aktorët e tjerë përkatës.

Programi i Subvencioneve

3 Përfundimi

Programi i subvencioneve ka dhënë rezultate jo të kënaqshme dhe të paqëndrueshme nga sektori në sektor. Programi i subvencioneve nuk ka ndikim në rritjen e prodhimit dhe rendimentit të kulturave bujqësore, përkundrazi ai vetëm subvencionon një pjesë më të lartë të shpenzimeve për të prodhuar të njëjtën sasi të këtyre kulturave. Edhe pse qëllimi i subvencioneve është të sigurojë qëndrueshmëri dhe stabilitet në bujqësi, duke marrë parasysh sasinë në rritje të subvencioneve, pritjet janë që rezultate do të duhej të ishin më të larta pozitive rendimentin e kulturave bujqësore.

3 Rekomandimi

Në funksion të fokusimit strategjik, subvencionet duhet të shpërndahen në dy nivele. Niveli i parë ka të bëjë me një mbështetje në vlerë minimale që do të subvenciononte të gjithë tokën bujqësore që kultivohet. Subvencioni i nivelit sekondar vlen për produktet strategjike - për shembull, nëse thekra nuk është një produkt strategjik, atëherë kualifikohet vetëm për subvencion të nivelit të parë, dhe nëse mjedra është një produkt strategjik, ai merr nivelin e parë dhe të dytë të subvencionit. Niveli i parë duhet të subvencionohet në varësi të sipërfaqes së kultivuar, ndërsa niveli i dytë duhet të përcaktohet në bazë të kapaciteteve të Agjencisë për Zhvillim e Bujqësisë, dhe mund të subvencionohet bazuar në sipërfaqen e kultivuar ose për njësi të prodhimit (d.m.th. kilogram). Të gjitha kapacitetet dhe nevojat aktuale duhet të merren parasysh dhe të llogariten, mes tjerash edhe sektorët e tjerë të qeverisë që janë të përfshirë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në procesin e zbatimit të programeve mbështetëse.

Programi i granteve

4 Përfundimi

Ekziston një kontroll i dobët i zbatimit të granteve dhe mungesë e matjes së duhur të efekteve dhe rezultateve të

arritura nga projekti. Edhe pse AZHB-ja ka procedura dhe doracakë, ato gjejnë zbatim të vogël gjatë procesit të zbatimit dhe monitorimit. Kapacitetet aktuale të AZHB-së janë gjithashtu të pamjaftueshme për zbatimin dhe monitorimin e suksesshëm të programeve mbështetëse të MBPZHR-së.

4 Rekomandimi

Programi i granteve duhet të monitorohet dhe të gjurmohen më rreptë, në mënyrë që të arrihet rezultati i synuar nga mbështetjen e ofruara. AZHB duhet të përdorë rreptësisht të gjitha procedurat dhe manualët e zbatimit dhe monitorimit. Presioni duhet të vihet mbi Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës për të akorduar buxhet dhe staf të mjaftueshëm për AZHB-në pasi ky institucion është një faktor kryesor në zbatimin dhe monitorimin me sukses të programeve mbështetëse të MBPZHR-së.

5 Përfundimi

Projektet për zhvillim gjithashtu kanë mungesë të këshillimit profesional për kultivimin e kulturave bujqësore, zhvillimit dhe përpunimit të aftësive pas-prodhimit, modeleve të biznesit, qeverisjes korporative dhe strategjive të shitjes.

5 Rekomandimi

Përfshirja e shërbimeve këshilluese, përmes këshilluesve profesionistë në projektet e granteve, duhet të jetë kërkesë e detyrueshme. Të gjitha palët e interesit në sektorin e bujqësisë duhet të investojnë në zhvillimin e kapaciteteve të shërbimeve këshilluese, pasi përfshirja e lartë e shërbimeve të tilla në projekte do të kontribuojë drejt stabilitetit dhe suksesit më të madh të masave mbështetëse, gjë që do të rezultojë në një sektor të qëndrueshëm bujqësor në tërësi.

Sistemi i informacionit dhe monitorimi

6 Përfundimi

Ekziston një mungesë e të dhënave dhe statistikave të qëndrueshme në sektorin e bujqësisë në Kosovë.

6 Rekomandimi

Duhet të përcaktohet një metodologji dhe procedura standarde për mbledhjen, përpunimin, vërtetimin dhe analizën e të dhënave në bazat e të dhënave të MBPZHR-së. Gjithashtu, metodologjia duhet të përfshijë të dhëna nga ASK, si dhe të dhënat nga niveli lokal (komunat), në mënyrë që të dokumentojnë dhe menaxhojnë të gjitha të dhënat e sektorit, duke ofruar një tablo të qartë të sektorit të bujqësisë.

Referencat

1 Anketa e Ndërmarrjeve Bujqësore (AHS), botuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, Republika e Kosovës, 2017

2 Programi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2014-2020 i përgatitur nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Republika e Kosovës, nuk është botuar.

3 Katalogu Ekonomik për Produkte Bujqësore 2018 publikuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Republika e Kosovës, 2019

4 Raporti i Gjellbër 2018 i botuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Republika e Kosovës, 2019

5 Intervistat e thella me palët përkatëse të interesit (shkurt-mars 2019), Kantar Index Kosova, Kosovë, 2019

6 Programi IPARD për 2014-2020 botuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Republika e Serbisë, 2017

7 Programi IPARD për 2014-2020 botuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Republika e Serbisë, 2017

8 Monitorimi i zhvillimeve të politikës bujqësore në vendet e Ballkanit Perëndimor botuar nga Qendra e Përbashkët Kërkimore, Spanjë, 2017

9 Programi për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale në Mal të Zi nën IPARD II 2014-2020 botuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Mali i Zi, 2016

10 Programi i Zhvillimit Rural 2014-2020 botuar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Republika e Shqipërisë, 2015

11 Punëtori me aktorët përkatës (Mars 2019), Kantar Index Kosova, Kosova 2019

